

# PROTOKOLL PËR MIRATIMIN E KONTROLLIMIT TË AFTËSIVE PËR SHKATHTËSI SPORTIVE TË NXËNËSVE TEK TË CILËT KA INTERES PËR REGJISTRIM NË SHMSH AKADEMINË SPORTIVE NË VITIN SHKOLLOR 2020/2021

## OBJEKTE SPORTIVE

1. Seleksionimi i nxënësve do të kryhet në terrene sportive nga lloji i hapur (futboll, hendboll, basketboll dhe tenis)
2. Në terrenet ku do të kryhet seleksionimi, duhet të kenë pjesë të veçantë për publikun në të cilën do të jenë të vendosur nxënësit, ku do të presin rendin e tyre për veprim në terren.
3. Midis sportistëve të ketë distancë fizike 2 metra, në pajtim me rekomandimet për distancimin social.
4. Ndërmjet trajnerit dhe kandidatit të ketë distancë prej 5metrash.
5. Para fillimit të trajnimit bëhet skringu termal dhe ndalohet trajnim të kandidatit i cili do të ketë temperaturë të lartë.
6. Përderisa nxënësit e presin rendin e tyre, detyrimisht të kenë me vete pajisje mbrojtëse (maskë).
7. Të ketë së paku dy tualete në përdorim, tërësisht të dezinfektuara.
8. Kandidatët dhe trajnerët vijnë në terren individualisht dhe të veshur me pajisje sportive për trajnimin selektiv, ku do të shmanget shfrytëzimi i dhomave të zhveshjes.
9. Lëvizja në terren sportiv të zhvillohet pas shenjave të shënuara edhe nga ana e kujdestarëve.
10. Para hyrjes të ketë të vendosur mjete për dezinfektim të duarve, e cila detyrimisht duhet të përdoret nga ana e nxënësve gjatë hyrjes dhe daljes nga terreni.
11. Në hyrje të ketë të vendosur sfungjer për dezinfektim të këpucëve.

## PARAQITJA

1. Para hyrjes në terren të ketë të vendosur pikë kontrolli për evidencë të nxënësve të cilët do të jenë pjesë nga trajnimet selektive. Sepse në këtë rast distanca fizike ndërmjet personit i cili kryen identifikim dhe nxënësit mund të jetë më pak se 2 metra, detyrimisht të përdoren pajisjet mbrojtëse (maskë mbrojtëse). Para qasjes të identifikimit, nxënësit duhet patjetër t'i dezinfektojnë duart me mjete për dezinfektim i cili do të vendoset në afërsi të vendit për identifikim.
2. Pranimi i kandidatëve (prania e tyre dhe identifikimi) do të kryhet nga persona të caktuar në vend të vendosur dhe të shënuar në vendin e hyrjes së terrenit me distancën e parashikuar ndërmjet kandidatëve dhe personave përgjegjës për pranimin.
3. Pas paraqitjes (identifikimit), nxënësit të drejtohen në vendin për publikë, ku presin të jenë të thirrur për veprim nga ana e trajnerëve që janë në terren.

## RRJEDHA DHE ORGANIZIMI I TRAJNIMIT SELEKTIV

1. Për organizimin e gjithë procesit të jetë përgjegjës shërbimi i kujdestarit e cila do të mbajë llogari për distancën e nevojshme midis kandidatëve dhe të pranishmëve prej minimum 2 metra në terren dhe rreth terrenit dhe në vendin e publikut ku do të jenë të thirrur kandidatët. Do të jenë të angazhuar minimum 2 kujdestarë.
2. Shenjat do të vendosen në hyrje të terrenit dhe në terrenin që do të tregojnë drejtim të lëvizjes dhe kujdes të distancës minimum gjatë pritjes rend.
3. Në terrenin të jenë të pranishëm së paku dy trajnerë, të cilët do të kenë detyrë të asistojnë në situata të caktuara gjatë demonstrimit në elemente të caktuara. Të njëjtit duhet të mbajnë pajisje mbrojtëse, respektivisht maskë dhe dorëza.
4. Pas çdo ndryshimi në terren, trajnerët detyrimisht duhet t'i dezinfektojnë duart me mjete për dezinfektim.
5. Komisioni prej tre anëtarëve ta ndjek trajnimin nga vendi përkatës, në distancë fizike midis anëtarëve prej 2 metrash.
6. Rekuizitat të cilat shfrytëzohen në trajnim të dezinfektohen pas çdo ndryshimi të bërë të nxënësit në terren.
7. Në demonstrim të elementeve të caktuara, në terren mund të ketë edhe dy nxënës njëkohësisht, por jo në distancë më pak se 3 metra.
8. Nxënësi, i cili e kryen veprimin e vet në terren, të drejtohet në dhomën e zhveshjes dhe pastaj ta lëshon terrenin.